

TERMAT E REFERENCES PER SIGURIMIN E PASURISË TË APD

Rreziqet që kërkohen të mbulohen nga polica e sigurimit:

SHKAKTARËT E HUMBJES, DËMTIMIT APO SHKATËRRIMIT TË PASURISË SË SIGURUAR TË APD, NË MËNYRË TË PAPRITUR, TË PAPANASHIKUAR DHE AKSIDENTALE MUND TË JENË:

TERMETI

Termeti duhet të jetë i regjistruar nga stacionet sizmike, si dhe të ketë një vlerë jo më të vogël se 4 Balle sipas shkallës Richter.

Shuma e siguruar e termetit të jetë 100 % e vlerës aktuale të objektit.

Objektet e siguruar nga Termeti përfshijnë Objektet në:

- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike në kabina
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurisë
- Tabelen 7- Inventari ekonomik në përdorim dhe depo

sipas përshkrimit në kolonën përkatëse të shtojcës Nr 3.

STUHIA

Stuhi do të konsiderohet një lëvizje ajri me forcë jo më të vogël se 8 balle (17.2m në sekond ose 62 km në orë) shkaktuar nga kushtet meteorologjike. Në qoftë se nuk ka matje nga stacionet meteorologjike që kjo forcë është mbizotëron kur ndodh kjo ngjarje, do të jetë e mjaftueshme nëq APD sjell të dhëna.

Siguruesi do të paguajë dëmshpërblimin për objektet e siguruar, të cilat janë shkatërruar ose dëmtuar nga stuhia, nëse shkatërrimi ose dëmtimi :

- Shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhisë ose
- Shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjesë të ndërtesës, pemë ose objekte të tjera brenda objekteve të siguruar ose ndërtesës në të cilin janë vendosur objektet e siguruar ose

- Eshte pasoje e humbjes ose demit te shkaktuar nga stuhia ne objekte e siguruara ose ne elemente te ketyre objekteve.

Shuma e siguruar e stuhise te jete 100 % e vleres aktuale te objektit.

Objektet e siguruara nga Stuhia perfshijne Objektet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
 - Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
 - Tabelen 5- Ndertesa
 - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
 - Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3
-

ZJARRI DHE RREZIQET SHTESE TE TIJ

- Zjarr do te konsiderohet te jete nje forme e djegies me flake e te mirave materiale, e afte te vetepershapet dhe te vetezgjerohet .
Ky perkufizim perfshin cdo forme te lindjes, dhe krijimit te zjarrit dhe qe prek objektet e siguara nga zjarri sipas Shtojces nr 3.
- Rrufe do te konsiderohet te jete nje shkrepje e rrufese e cila godet nje object direct ose indirekt.
- Eksplozion do te konsiderohet te jete nje clirim i papritur i energjise i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve ne perpjekje per zgjerim. Ne se shkak per shperthimin brenda enes eshte nje reaksion kimik, atehere do te demshperblehet cdo demtim i enes, dhe ne se paretet e saj nuk jane shkaterruar.
- Renie avionesh apo pjese te tij.

Shuma e siguruar e zjarrit te jete sipas percaktimeve ne Listen bashkangjitur si Shtojca 3.

Objektet e siguruara nga Zjarri perfshijne Objektet/ pajisjet/materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
 - Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
 - Tabelen 4- Mjete Transporti dhe makineri,
 - Tabelen 5- Ndertesa
 - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
 - Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3
-

RRESHQITJA E TOKES

Ky sigurim mbulon humbjen ose demin per shkak te rreshqitjes se siperfaqes se tokes ne zona te pjerreta, me plasaritje dhe çarje ne forme damaresh, qe shihen qarte, te cilat ne periudha te shkurtera kohe shkaktojne deformacione statike te rrezikshme ose çarje te medha ne ndertesat.

Shuma e siguruar e zjarrit te jete Vlera e mbetur ne Bilanc dhe Vlera e rikthimit te objektit ne gjendjen para demit, te detajuara keto sipas percaktimeve ne Listen bashkangjitur si Shtojca 3.

Objektet e siguruara nga Rreshqitja e Tokes perfshijne Objektet/ pajisjet/materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabelen 4- Mjete Transporti dhe makineri,
- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimet perkates ne shtojcen Nr 3

MBULIM SHTESE – Demi ne Aparaturat dhe paisjet i shkaktuar nga rryma elektrike

Ky sigurim mbulon:

1. Dëmin në çdo makineri dhe aparature elektrike dhe elektronike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik dhe elektronik të shkaktuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit,
2. Dëmin në çdo makineri dhe aparature elektrike dhe elektronike, ose në çdo pjese të instalimit elektrik/electronik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte ose indirekte e rrufesë.

Shuma e siguruar e Mbulimit Shtese te jete 100 % e vleres aktuale te objektit/pajisjeve/materialeve.

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke.

Objektet e siguruara nga Zjarri Mbulim Shtese perfshijne Objektet/ pajisjet /materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
- Tabelen 5- Ndertesa
- Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- Tabelen 7- Inventari ekonomik ne perdorim dhe depo sipas pershkrimet perkates ne shtojcen Nr 3

SIGURIMI I DEMENTIMEVE TE MAKINERIVE

Siguresi demshperblen humbjen ose demtimin fizik te papritur dhe te paparashikuar, qe ben te domosdoshme riparimin ose zevendesimin e makinerive si pasoje e:

1. aksidenteve te rastesishme ne pune te tilla si mospershtatje, lirimi i pjeseve, demtime ose defekte te pjeseve mbrojtese, hyrjes se personave te jashtem.
2. shkeputje pjesësh si rezultat i forces centrifugale
3. mungeses se ujit ne boilerat me avull ose eneve me presion
4. mbi-presionit ose shperthimi
5. qark i shkurter, mbi-voltazh/ mbi- rryme elektrike
6. defekteve ne montim
7. veprimeve e gabuara, mungeses se aftesive, pakujdesise se punonjesve.

Objektet e siguruara nga Demtimit e Makinerive perfshijne Makinerite ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
 - Tabelen 2- Pajisje zyra dhe elektrike ne kabina
 - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- sipas pershkrimet perkates ne shtojcen Nr 3

Pjesen e zbritshme e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor deri ne 5000 Leke.

SIGURIM KASKO

Me sigurim kasko te plote nenkuptohet mbulim i plote i demeve sipas pikave te meposhtme :

- 1-thyerje e xhamave;
- 2-dentime aksidentale;
- 3-zjarr, rrufeja, eksplozioni;
- 4-katastrofa natyrore,
- 5- vjedhje

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke

Mjetet per Sigurim Kasko jane percaktuar ne:

- Tabelen 4- Mjete Transporti dhe makineri sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3
-

SIGURIM TPL

- Pjesen e zbritshme deri ne 5000 Leke

Mjetet per Sigurim TPL jane percaktuar ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
- Tabelen 4- Mjete Transporti dhe makineri sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3

DEME NGA PALET E TRETA

Me veprime nga palet e treta do te kuptohet humbja, shkaterrimi ose dentimi aksidental i shkaktuar nga (zjarri, eksplozioni ose te tjera) e Pasurise se siguruar shkaktuar direkt ose indirekt nga palet e treta (çdo person fizik apo juridik ose grup personash).

Ne Momentin e Ngjarjes se siguruar sipas ketij seksioni, fillimisht Siguruesi paguan demshperblimin karshi te Siguruarit, dhe I Siguruarit i jep te drejten Siguruesit per te marre shperblimin nga pala e trete per demin e shkaktuar.

Objektet e siguruara nga Deme nga Pale te Treta perfshijne Objektet/ pajisjet /materialet ne:

- Tabelen 1- Elektrovinca
 - Tabelen 5- Ndertesa
 - Tabelen 6- Sistemet e Sigurise
- sipas pershkrimit perkates ne shtojcen Nr 3

PERGJEGJESI NDAJ PALEVE TE TRETA

Pergjegjesi Publike e percaktuar si:

Demshperblim i te siguruarit ndaj shumave per te cilat i siguruari do te jete ligjerisht i detyrueshem te paguaje per te zhdemtuar aksidente ndaj cdo personi dhe /ose humbje apo demtime te prones te personave te trete ne ambientet e tij.

Limiti i Pergjithshem i demshperblimit do te jete 100,000,000 Leke per cdo ngjarje dhe 200,000,000 Leke per te gjithe periudhen e sigurimit.

Pjesa e Zbritshme maksimale e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor do te jete 5, 000 Leke.

Pergjegjesi e produktit(aktivitetit), ku perfshihen:

- 1.Demttime trupore(vdekje, semundje te/ose mjë personi)
- 2.Humbje ose demtime fizike të sendeve(pasurisë së trupëzuar)
- 3.Pergjegjësia profesionale(demtmet e shkaktuara nga el/vincierët dhe drejtuesit e automekanizmave)

Shkaktuar nga sherbimet/mallrat , shitur, furnizuar,instaluar, montuar, riparuar, ndryshuar ose trajtuar nga i siguruari, ndodhur gjatë periudhës së demshperblimit të siguruar, jashtë njësisë së të siguruarit.

Limiti i Pergjithshem i demshperblimit do te jete 100,000,000 Leke per cdo ngjarje dhe 200,000,000 Leke per te gjithe periudhen e sigurimit.

Pjesa e Zbritshme maksimale e pranueshme nga Autoriteti Kontraktor do te jete 5, 000 Leke.

Per asetet (sipas listes se objekteve per tu siguruar) te APD-se te cilat ne momentin e lidhjes se kontrates vazhdojne te jene te siguruara, siguracioni i tyre do te kryhet pas mbarimit te siguracionit aktual